

From: rezana celmeta
Sent: Thursday, May 24, 2018 11:24 AM
To: denis_tahiri@ymail.com
Subject: Kthim pergjigje

Pershendetje,

ne pergjigje te kerkeses tuaj, te dates 30.04.2018, te derguar me email ne adrese te koordinatorit per te Drejten e Infomimit ne DPT, ne baze te Ligjit nr.119/2014 "Per te drejten e Informimit", regjistruar ne Regjistrin e kerkesave dhe pergjigjeve me nr.66, ne te cilen kerkoni informacion ne lidhje me taksat dhe tatime qe aplikohen mbi tregetine e naftes, pas shqyrtimit te kerkeses e cila ishte ne perputhje me nnein 11 te Ligjit te sipercituar, ju infomoj sa me poshte vijon:

TAKSA, TVSH, TATIM - FITIMI, AKCIZA

I. TAKSAT

Ligji Nr 9975 datë 28.07.2008 “ Për Taksat Kombëtare” ka përcaktuar llojet e taksave dhe tarifave kombëtare që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, nivelin e taksave kombëtare, procedurat e llogaritjes, të arkëtimit dhe transferimit në Buxhetin e Shtetit për tatimpaguesit të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e prodhimit dhe tregëtimit të hidrokarbureve.

Konkretisht taksat që aplikohen në industrinë e hidrokarbureve janë:

1. Taksa e rentës minerare

Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues. Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën e përgjithshme të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës në masën 10%

Shënim: Kjo taksë aplikohet ndaj tatimpaguesve të cilët ushtrojnë veprimtarinë në fushën e nxjerrjes së hidrokarbureve.

2. Taksa e karbonit për benzinën për gazoilin, për qymyrin, për vajgurin për solarin, për mazutin dhe për koks naftë.

Taksa e karbonit caktohet në masën 1,5 lekë për litër për benzinën, 3 lekë për litër për gazoilin, 3 lekë për kilogram për qymyrin, 3 lekë për solarin, 3 lekë për mazutin, 3 lekë për litër për vajgurin dhe 3 lekë për kilogram për koks naftë.”

3. Taksa e qarkullimit për benzinën dhe për gazoilin

Taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin caktohet në masën 27 lekë/litër për benzinën dhe 27 lekë/litër për gazoilin.

II . TVSH

Ligji Nr.92/2014, datë 27.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhezimit Nr 6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Ligji Nr Nr. 8438, datë 28.12.1998” Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar ka përcaktuar tatimet që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, ndaj tatimpaguesve të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e tregëtimit të hidrokarbureve.

Tatimi mbi vlerën e shtuar.

Ky tatim aplikohet për të gjithë tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e tregëtimit të hidrokarbureve në import dhe në shitje në masën 20%, përveç disa përjashtimeve të parashikuara për:

- fazën e kërkimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët, të vërtetuar si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, lidhur me realizimin e fazës së kërkimit, si dhe furnizimi i mallrave që bëjnë kontraktorët për njëri-tjetrin ose nënkontraktorët për kontraktorët e tyre, të importuara sipas pikës 39, të nenit 56, të këtij ligji.
- Importimi i mallrave dhe i shërbimeve, që lidhen me realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët që punojnë për këto operacione. Kontraktorët dhe nënkontraktorët vërtetohen si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për energjetikën përcaktojnë me udhëzim të përbashkët listën e mallrave dhe shërbimeve të lidhura me fazën e kërkimit, si dhe procedurën e përjashtimit nga TVSH

III. TATIM MBI FITIMIN

Baza ligjore : ligji 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar
Mbi bazën e këtij ligji keto subjekte paguajnë Tatim mbi Fitimin, i cili aplikohet për të gjithë tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e tregëtimit të hidrokarbureve në masën 15%.

IV. AKCIZA

Ligji i akcizës, zbatohet nga administrata doganore.

Përveçse sa me sipër këta tatimpagues janë gjithashtu të ngarkuar me përgjegjësinë tatimore të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, Tatimit mbi të ardhurat nga pUnesimi TAP, Tatimit në burim etj.

Për të marrë më shumë informacion në lidhje me Legjislacionin tatimor në fuqi, ju mund të konsultoni edhe :

<https://www.tatime.gov.al/>

<https://www.tatime.gov.al/c/6/legjislacioni>

<https://www.tatime.gov.al/c/6/69/procedurat-tatimore>

<https://www.tatime.gov.al/c/6/70/tatimi-mbi-te-ardhurat>

<https://www.tatime.gov.al/c/6/71/tatimi-mbi-vleren-e-shtuar>

<https://www.tatime.gov.al/c/6/72/taksat-kombetare>

<https://www.tatime.gov.al/c/6/73/kontributet-e-sigurimeve-shoqerore-dhe-shendetesore>

Faleminderit për mirekuptimin

Pune të mbare